

## **Njoftim mbi fillimin e procedurave të prokurimit të energjise për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit :**

Të nderuar,

OST sh.a, do të filloj të prokurojë energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit per vitin 2018, konform Vendimit te ERE nr. 103, datë 23.06.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për Procedurat e Blerjes së Energjisë Elektrike për mbulimin e humbjeve në Rrjetet e Shpërndarjes dhe të Transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

Përsa më sipër, nëpërmjet këtij njoftimi, dëshirojmë t’ju bëjmë me dije mbi mundësinë e pjesëmarrjes në Procedurat e Blerjes së Energjisë, për mbulimin e Humbjeve në Rrjetin e Transmetimit. Për të marrë pjesë në procedurat e blerjes së energjisë, çdo shoqëri e licencuar për tregtimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe/ose cdo Palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë që dëshiron të marrë pjesë në procedurën e blerjes së energjisë elektrike, duhet të paraqesë në faqen zyrtare të OST sh.a, (<https://www.ost.al/index.php/sq/aplikimi-per-regjistrim/>) dokumentacionin e nevojshëm si më poshtë vijon:

- a) Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat përkatës tregtarë/gjyqësorë të shtetit në të cilin shoqëria është krijuar apo regjistruar.
- b) Licencën për tregtimin e energjisë elektrike të lëshuar nga ERE për tregtarët të cilët janë krijuar apo regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo shtetet përkatëse për ata Tregtarë të energjisë elektrike të cilët janë krijuar apo regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë .
- c) Dokumentacionin lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës jo më vonë se 3 muaj që nga paraqitja e ofertës I cili duhet të vërtetojë që:
  - Tregtari nuk është në process falimentimi (document i lëshuar nga QKR)
  - Tregtari apo përfaqësuesit ligjore të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për shkelje penale
  - Tregtari apo përfaqësuesit ligjore të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- d) Përvec dokumentacionit të sipërcituar, ju duhet të paraqisni dhe dokumentacionin e shprehjes së interesit, formatin e të cilit e gjeni bashkëlidhur.

Për procedurat e blerjes së energjise që do të zhvillohen në muajin Dhjetor 2017, dokumentacioni i paraqitur duhet të dërgohet pranë OST sh.a, brenda dates 12/12/2017.

Njoftojme se OST sh.a, do të pranojë ose refuzojë dokumentacionin, brenda 3 ditësh pune, nga data e paraqitjes së dokumentacionit përkatës. Në rast se brenda 3 ditësh pune nga dorëzimi i dokumentacionit, OST sh.a, nuk ka dalë me një përgjigje, dokumentacioni konsiderohet i miratuar në heshtje. Subjektet duhet të kenë paraqitur dokumentacionin dhe të kenë marrë përgjigje definitive nga OST sh.a, përpara se të marrin pjesë në procedurën e blerjes së energjisë.

Ju faleminderit!